

20222744160

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË PUNËSIMIT DHE TË SIGURIMIT NË RASTE
PAPUNËSIE

Neni 1

Ligji i Punësimit dhe i Sigurimit në Raste Papunësie (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/97, 25/00, 101/00, 50/01, 25/03, 37/04, 4/05, 50/06, 29/07, 102/08, 161/08, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15, 154/15, 27/16, 119/16, 21/18 dhe 113/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Veriut” nr. 124/19 dhe 103/21), neni 87-q dhe ndryshohet dhe bëhet:

“Paga e ofruesve të shërbimeve publike dhe personave ndihmës-teknikë përbëhet nga komponentët në vijim:

- Komponentët themelorë dhe
 - Komponentët e jashtëzakonshëm
- Komponentin themelor të pagës e përbëjnë:

- Paga minimale,
- Pjesa e pagës për shkallën e arsimit,
- Pjesa e pagës në nivel dhe
- Pjesa e pagës për përvojë pune

Pjesa e pagës për shkallën e arsimit që është minimum ligjor për nivelin përkatës të vendit të punës vlerësohet në mënyrën siç vijon:

NIVELI I KUALIFIKIMEVE/ARSIMI	PIKË
Niveli i kualifikimeve VI A, 240 kredi sipas EKTC ose shkalla VII/1 e përfunduar	56
Niveli i kualifikimeve VI B, ose 180 kredi sipas EKTC	31
Niveli i kualifikimeve V A, 90 deri 120 kredi sipas EKTC ose arsimit të lartë	11
Niveli i kualifikimeve IV, 180 kredi sipas ECVET ose MKCOO ose shkollë e mesme katërvjeçare	1

Pjesa e pagës për nivelin e pagës në të cilën i punësuari është i klasifikuar vlerësohet në këtë mënyrë:

NIVELI	PIKË
OFRUESIT E SHËRBIMEVE PUBLIKE	
Kategoria A	
A1- koordinator i departamentit	172
A2- nëpunës i lartë profesional për përgatitjen për punësim	106
A3- nëpunës profesional i pavarur për përgatitje për punësim	71
A4- nëpunës profesional për punësim	56
A5- nëpunës profesional i ri për përgatitje për punësim	25
Kategoria B	
B1- koordinator i departamentit	172
B2- nëpunës i lartë profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit	106

B3- nëpunës i pavarur profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit	71
B4- nëpunës profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit	56
B5- nëpunës i ri profesional për ndërmjetësim gjatë punësimit	25
PERSONA NDIHMËS-TEKNIKË	
Kategoria A niveli A1	15
Kategoria A niveli A2	10
Kategoria A niveli A3	5

Pjesa e pagës për përvojën e punës e ofruesve të shërbimeve publike dhe të personave ndihmës-teknikë vlerësohet në vlerë prej 0,5% nga përmbledhja e pagës minimale, pjesa e pagës për shkallë të arsimit dhe pjesa e pagës për nivel, për çdo vit të përfunduar të përvojës së punës, ndërsa më së shumti deri 20%.

Neni 2

Dispozitat sipas nenit 1 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 87-q do të zbatohet me pagesën e pagës për muajin mars të vitit 2022.

Neni 3

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekstin e konsoliduar të Ligjit të Arsimit dhe të Sigurimit në Raste papunësie.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.